



Save the Children



Tiranë më 07.12.2015

Drejtuar: Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Nga: Organizatat e Shoqërisë Civile

Save the Children Albania

Milieukontakt International Albania

Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center)

Fondacioni Down Syndrome Albania (DSAlbania)

Lënda: Mbështetje jo e plotë dhe shpërndarje jo efektive e buxhetit për arsimin nëntë-vjeçar dhe të mesëm.

I nderuar Z. Pollo,

Duke ju falenderuar, për mundësinë për të ndarë me anëtarët e nderuar të komisionit parlamentar të Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik, këtë propozim, po ju paraqesim, shumë shkurt, disa nga argumentat kryesore dhe shifrat konkrete lidhur me shqetësimin tonë.

Organizatat tona e kanë mbështetur nismën e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Shkolla si Qendër Komunitare – Një shkollë miqësore për të gjithë”, e cila synon shëndërrimin e shkollës në një hapësirë partneriteti të ri mësues-familje-komunitet.

Për të rritur eficienten e politikave të reja arsimore dhe të projekteve konkrete, me detyrimin për të qënë sa më aktiv në (i) përmirësimin, hartimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive sektoriale, (ii) identifikimin e projekteve me impact sa më të madh social dhe (iii) për të lobuar për mbështetjen e tyre buxhetore në PBA dhe në buxhetet vjetore, si dhe pas një analize të hollësishme profesionale të SKZHI, strategjive sektoriale, buxhetit afatmesem dhe draft buxhetit të vitit 2016 po ju paraqesin shqetësimin tonë në gjashtë elementë thebësorë:

I.Shkalla e mbështetjes është e vogël dhe përzgjedhja e projekteve konkrete është jo efektive.

Kjo sepse :

- (i) Mungon transparenca në cdo hap të përgatitjes së strategjive dhe buxheteve – kjo pengon dhe dëmton kontributin tonë;
- (ii) Draft buxhetit – është i cunguar pasi nuk kemi akses për projektet konkrete, kjo pengon identifikimin që në fazat e para të problemeve lidhur me shkallën e mbështetjes dhe cilësinë e përzgjedhjes së projekteve që financohen nga buxheti;
- (iii) Investimet publike sipas projekteve konkrete kanë vështirësi për tu analizuar në raport më të pritshmin, PBA 2015-2017, kjo pengon fokusimin e investimeve publike, rrit kostot dhe vonon efektin e tyre pozitiv.

Lidhur me projektet konkrete: (i) shkalla e mbështetjes është jo në përputhje me objektivat e PBA 2014-2020 (ku nga 7000.0 të përcaktuar në PBA 2015-2017 është zvogëluar në 4974.3 në projekt buxhetin 2016 për shkollat si Qendra Komunitare); (ii) shpërndarja e projekteve në buxhetin 2016

është e përqëndruar vetëm në 3 rrethe dhe me disa projekte në të njëjtën zonë dhe (iii) ky projekt kërkon angazhimin edhe të komuniteteve lokale, si bashkitë, prindërit, donatorët lokale dhe ndërkombëtare. Mbeshteja në rritje vjen vetëm kur ata inspirohen nga modele suksesi. Modelet e suksesit duhet të fillojnë nga zonat ku varferia është më e madhe, braktisja e shkollës në nivele shqetësuese dhe cilësia e arsimimit e dobët.

II. Transferta e pa kushtëzuar për cdo nxënës është e pamjatueshme.

5% e transfertës së pakushtëzuar ose **634,662,407 lekë** do të alokohen mbi numrin faktik të nxënësve në shkollat publike nëntë-vjecare dhe të mesme. Vlera e transfertës që do marrin bashkitë për cdo nxënës është vetëm **1.424 lekë**. Mesatarizimi i transfertes dëmton fëmijët me AK dhe kjo bie ndesh me objektivat e arsimit gjithëpërfshirës. Fatkeqësisht Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk ka akoma një shifër të saktë sesa është numëri i fëmijëve me AK në shkollat dhe sa është kostoja e një fëmije me AK. Është përcaktuar kostoja vetëm për fëmijët në shkollat speciale

III. Mësuesit ndihmës për fëmijët me AK nuk dalin si zë më vete në buxhet dhe rrjedhimisht nuk dihet sa është numëri i tyre. Ndërkohë, në 14 shkollat ku punon Save the Children, të cilat ndodhen në 7 qarqe dhe ku janë regjistruar 81 fëmijë me Ak, nuk rezulton të ketë asnjë mësues ndihmës.

IV. Shpenzimet për psikologët janë shumë të ulëta dhe kjo e vë në pikepyetje shtrirjen e këtij shërbimi në të gjitha shkollat.

V. Shpeznimet për trajnimin e mësuesve janë të ulta (ato mund të përkthehen mesatarisht 4 ditë trajnimi për mësues në vit)

VI. Investimet për kabinete dhe laboratore janë të ulta. Në buxhet janë planifikuar 10 milion për mobilim laboratorësh dhe 30 milion lekë për pajisje laboratorike (kimi, fizikë, biologji). Këto investime janë sa 2.95% e investimeve në Arsimin Bazë. Në v.2013 dhe v.2014 shpenzimet për laboratore kanë qënë zero. Mungesa e investimeve në këto produkte cënon cilësinë e mësimdhënies në shkollat ku baza materiale mungon.

Përgatitur nga:

Irena Çelaj

Save the Children Albania



Margarita Buxhaku

Milieukontakt International Albania



Elvis Çela

Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim (EPER Center)



Mirela Juka

Fondacioni Down Syndrome Albania (DSAlbania)

